

Neni 22

Njësia e shërbimit ligjor

1. Pranë Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, në varësi të mbledhjes së komisionerëve ose gjyqtarëve.

2. Procesi i rekrutimit bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti ad hoc i krijuar në institucionin përkatës.

3. Këshilltari ligjor është shtetasi shqiptar, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) ka pasur një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;

ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

d) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

4. Këshilltari ekonomik është shtetasi shqiptar, i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematikë ose drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) ka pasur një përvojë pune në sektorin financiar jo më pak se 7 vjet;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;

ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

d) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;